

**STATUT I SHOQERISE**  
**“LOKU ON THE BEACH ” Sh.P.K.**

*Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.*

Sot, me 09.02.2022, personi i mëposhtëm:

**Z. BESART KALLAKU**, atesia Shyqyri, memesia Shpresa, shtetas Shqiptar, me ditelindje 20.11.1985, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga Mine Peza, Nd. 43, H.0, Ap. 0, Njesia Administrative nr. 9, mbajtës i dokumentit karte Identiteti me nr 038079062, nr. Personal I511200007G, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, ka miratuar këtë Statut si vijon:

**KAPITULLI I**  
**THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA - OBJEKTI – KOHEZGJATJA**

**Neni 1**

**Themelimi, Emri dhe Forma**

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqërisë është “LOKU ON THE BEACH ” Sh.P.K. Shoqëria “LOKU ON THE BEACH ” Sh.P.K. është një person juridik privat, e themeluar në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (me pas referuar si “Ligji Tregtar”) në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.P.K.). Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (me pas referuar si “QKR”) në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji. Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqëria behet përgjegjëse kundrejt paleve të treta, për detyrimet dhe demet që shkakton gjatë veprimtarisë së saj. Ortaket e Shoqërisë do të jenë përgjegjës kundrejt paleve të treta deri në shumën e kontributit të derdhur në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

**Neni 2**

**Selia**

Shoqëria do të ketë seline të saj në adresën e mëposhtme: Rruga Bilal Sina, pallati nr. 4, ap. 17, Selitë Tiranë. Me vendim të Administratorit, Shoqëria mund të çele dege dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

**Neni 3**

**Objekti**

Objekti veprimtarisë Shoqërisë do të përfshijë sa vijon:

Marketing, konsulence financiare, konsulence menaxhimi biznesit. Konsulence për perzgjedhjen e strukturas juridike dhe administrative. Konsulence për format me të mira me të mira të financimit dhe të investimit. Ofron parashikime mbi temat financiare dhe ekonomike të cilat janë të lidhura ngushtë



me vijueshmerine e aktivitetit. Zgjidhje per probleme dhe ceshtje qe dalin gjate veprimtarise ne lidhje me vleresimin dhe mbarevajtjen e investimit. Analizon strukturen financiare, Bilancin, Pasqyren e te Ardhurave dhe Shpenzimeve. Konsulence mbi problematikat fiskale, kontabile dhe bilancin. Pergatitjen e pasqyrave financiare ne perputhje me standartet e kontabilitetit shqiptar, dhe te tjera raporteve financiare te kerkuara nga aksioneret, keshilla profesionale ne lidhje me strukturen paraqitjen dhe zbulimin e pasqyrave financiare. Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqërisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm. Objekti i aktivitetit të Shoqerise mund te ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe kete Statut.

#### **Neni 4 Kohezgjatja**

Kohezgjatja e Shoqerise eshte e pakufizuar. Shoqeria mund te priset ne cdo kohe me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

### **KAPITULLI II KAPITALI – KUOTAT**

#### **Neni 5 Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 200,000Leke (dyqind mije). Kapitali themeltar perbehet nga 1 (nje) kuote qe eshte paguar e zoterohet teresisht nga ortaku themelues si vijon:

- Ortaku Besart Kallaku zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 200,000 leke, qe perfaqeson 100% te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Ortaku eshte pergjegjes kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit te tij ne kapitalin themeltar. Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

#### **Neni 6 Kuotat Te drejtat dhe detyrimet e lidhura**

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratoreve (“Regjistri i Ortakeve”).

Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotes qe zoterohet nga cdo Ortak; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

#### **Neni 7 Transferimi i Kuotave**

- 7.1. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje ne cdo forme te gjithë apo nje pjese te kuotes se tij nje personi te ndryshem nga Ortaket, secili prej Ortakeve te tjere ka te drejten e parablerjes mbi te gjithë apo nje pjese te kuotes ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar, ne varesi te faktit se sa ortake do te ushtrojne te drejten e parablerjes ne rastin konkret. E drejta e



parablerjes ushtrohet vetem ne perputhje me proceduren ne vijim.

- 7.2. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje te gjitha apo nje pjese te kuotes se tij, ai, perpara se te nenshkruaje marreveshje me persona te ndryshem nga Ortaket, do te njoftoje me shkrim Administratoret per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t'u transferoje kuoten dhe kushtet esenciale qe do te aplikohen per transferimin.
- 7.3. Administratoret, brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaku per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te informojne me shkrim Ortaket e tjere.
- 7.4. Secili prej Ortakeve qe ka te drejta parablerjeje, brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratoreve per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te njoftoje me shkrim Administratoret nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.
- 7.5. Administratoret brenda 10 diteve nga marrja e ketij njoftimi do te njoftojne me shkrim Ortakun qe deshiron te transferoje kuotat e tij.
- 7.6. Nese me shume se nje Ortake ushtrojne te drejtat e parablerjes se kuotes, ata do te blejne kuoten ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar.
- 7.7. Nese asnje njoftim nuk eshte dhene nga ndonje Ortak si me siper, Ortaku qe ka per qellim te transferoje kuoten e tij do te jete i lire t'ia transferoje kete kuote personit/ave te percaktuar prej tij.
- 7.8. Nese vetem nje Ortak ka dhene njoftim per qellimin e tij per te ushtruar te drejten e parablerjes, ky Ortak do te kete te drejte te bleje kuoten objekt transferimi brenda 10 diteve nga data e mbarimit te afatit 1 (nje) mujor te percaktuar me siper.
- 7.9. Çdo transferim i kuotave qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshte i pavlefshem dhe pa efekte per Shoqerine.

#### **Neni 8 Zmadhimi i Kapitalit**

Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjetere te parashikuar nga Ligji. Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejtat e tyre te parablerjes brenda 20 (njetzet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuote e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete. Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.

#### **Neni 9 Zvogelimi i Kapitalit**

Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

### **KAPITULLI III ORGANET E SHOQERISE**

#### **Neni 10 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve**

Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per çeshtjet e meposhtme te



**Shoqerise:**

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi i Administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
- g. shperndarjen e fitimeve vjetore;
- i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
- j. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
- k. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
- l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- m. miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. ceshtje te tjera sipas parashikimeve te bera prej ketij Statuti.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projektvendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 14 (katërmbëdhjetë) dite para mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per çdo çështje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.

Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si: percaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar; percaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore

dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.  
Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve që percaktojnë detyrime shtese ose kufizojnë / zvogelojnë të drejtat që u janë njohur ortakeve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtëzohet nga miratimi i Ortakut të interesuar / perkates.

Te gjitha vendimet e Asamblese duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.

#### **Neni 11**

#### **Organi Administrues / Administratorët**

Organi Administrues përbehet nga 1 (një) Administrator që emrohet e shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit të Administratorit është 5 (pese) vjet, me të drejtë ri-emerimi.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë me mandat 5 vjeçar:

**Z. Besart Kallaku**, atesia Shyqyri, memesia Shpresa, shtetas Shqiptar, me ditelindje 20.11.1985, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga Mine Peza, Nd. 43, H.0, Ap. 0, Njesia Administrative nr. 9, mbajtës i dokumentit kartë Identiteti me nr 038079062, nr. Personal I511200007G, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar,

Administratori përfaqëson Shoqërinë sipas parashikimeve të Statutit dhe do të:

- (i) administrojë veprimtarinë tregtare të Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve;
  - (ii) përfaqësojë Shoqërinë;
  - (iii) kujdeset për mbajtjen e rregullt të librave dhe dokumenteve kontabel;
  - (iv) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat ia paraqet Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
  - (v) krijojë një sistem njoftimi të përshtatshëm për rrethanat që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë;
  - (vi) kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit Tregtar apo të ligjeve të tjera të zbatueshme;
  - (vii) raportojë përpara Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe për perfundimin e transaksioneve me rëndësi të veçantë për performancën e Shoqërisë;
  - (viii) kryejë detyra të tjera, të percaktuara në Ligjin Tregtar dhe në këtë Statut;
  - (ix) thërresë mbledhjen e Asamblese së Ortakeve sa herë që kërkohet sipas Ligjit apo këtij Statuti.
- Administratori mund të autorizojë persona të tjerë për të vepruar në emri dhe për llogarinë e tij, duke specifikuar / percaktuar kategorinë e akteve dhe veprimeve që përfaqësojë mund të kryejë.  
Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosen kufizime të kompetencave të administrimit.

#### **Neni 12**

#### **Kontrolli i Shoqërisë**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve mund të emerojë një ose disa eksperte kontabel të autorizuar për kontrollin e llogarive të Shoqërisë.

#### **KAPITULLI IV**

#### **VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE**

#### **Neni 13**

#### **Viti Financiar**

Viti financiar ka një kohezgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31

Dhjetor te cdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

**Neni 14**  
**Rezerva Ligjore**

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

**Neni 15**  
**Dividendet**

Pas miratimi te bilancit vletor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndaht secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

**KAPITULLI V**  
**PRISHJA - LIKUIDIMI**

**Neni 16**  
**Prishja e Shoqerise**

Shoqeria priset :

- (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose
- (ii) ne rast falimentimi; ose
- (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKR; ose
- (iv) me vendim gjykate; ose
- (v) per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

**Neni 17**  
**Likuidimi**

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

**Neni 18**  
**Dispozita Perfundimtare**

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.

Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e se ciles Shoqeria ka seline e saj.

Me qellim shmangien e cdo paqartesis, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose cdo funksionari tjetar nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

Ky Statut nenshkruhet rregullisht ne 3 (tre) origjinale ne gjuhen Shqipe .

**ORTAKU THEMELUES**

*Besart Zallari*  
*P. Zallari*